



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Qershor, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

**1. PËRMBLEDHJE**

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Arsimit, përkundur sfidave të mëdha që ka paraqitë përhapja e virusit COVID-19, gjatë muajit qershor me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë ka arritur të realizojë punë dhe detyra të shumta, të parapara sipas planit të veprimit dhe punë e detyra tjera të paraqitura.

**AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA. Rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Sigurimi i koordinitorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;

- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Mbikëqyrja/mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatim i monitorimit të kurrikulës;
- Organizohen takime dhe punëtori për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikohen nevojat e shkollës për mjete të TIK-së;
- Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-së;
- Identifikimi i nevojave të mësimdhënësve për trajnime;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;

- Vlerësimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim profesional të edukatoreve dhe personelit administrativ;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësime të gabuara që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- DKA përkrah NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Indeksi i sigurisë;
- Vlerësimi i tenderit “ Furnizimi me inventar i institucioneve arsimore”;
- Fillimi i implementimit të furnizimit me perde të institucioneve arsimore;
- Mbledhja e të dhënave për furnizim me libra për nxënësit e klasave 1-9;
- Fillimi i furnizimit me material higjienik i institucioneve arsimore;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance;

## 2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e organizimit dhe zhvillimit të mësimit në distancë në institucionet edukativo-arsimore në nivelin e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, përmes platformave digjitale, duke i përcjellë ecuritë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatoren e cilësisë në nivel komune, dhe njëkohësisht në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, ku deri tani janë caktuar mbi 29 koordinatore në nivel shkolle;
- **Mësimi në distancë**  
Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim dhe bashkëveprim me Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe mekanizma të tjerë mbështetës, kanë vazhduar me organizimin e mësimit në distancë, për nivelin e arsimit fillor (I-V) dhe nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX) edhe gjatë muajit qershor 2020;

- **Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të mësimitdhënësve**

Drejtoria e Arsimit, më 19 qershor 2020, pranoi nga përfaqësuesit e projektit të Bashkimit Evropian certifikatat e 217 mësimitdhënësve për ndjekjen e trajnimeve: "Qasje praktike për zbatim të kurrikulës në klasat 0 - 5" dhe "Mentorimi me bazë në shkollë", si dhe certifikatat e shtatë trajnerëve të ekipit të DKA-së për programin "Qasje praktike për zbatim të kurrikulës në klasat 0 - 5". Gjithashtu u pranuan edhe materialet dhe udhëzuesit e përgatitur nga projekti "Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve" të cilat mund të përdoren nga DKA dhe shkollat.



Së bashku me trajnerët e certifikuar dhe materialin e zhvilluar nga projekti, DKA-të tani kanë mundësi të organizojnë trajnimet me bazë në shkollë sipas kërkesave të mësimdhënësve.

Trajnimet janë mbështetur nga projekti “Zhvillimi profesional i mësimdhënësve”, i financuar nga Bashkimi Evropian, dhe janë ofruar gjatë periudhës, tetor 2019 - mars 2020;

- Implementimi i platformës digjitale E-shkollori, projekt inovativ i cili implementohet nëpër faza të caktuara dhe sistemi arsimor i DKA-Prishtinë parashihet të jetë plotësisht i digjitalizuar;
- Drejtorja e Arsimit, më 05 qershor 2020, ka realizuar takim me drejtuesit e shkollave fillore dhe të mesme të larta, për t’i informuar lidhur me organizimin dhe mbajtjen e mësimit plotësues për nxënësit e klasave (IX dhe XII), Testin e arritshmërisë dhe Testin shtetëror të maturës;
- Në Drejtorinë e Arsimit, më 13 qershor 2020, u pritën në takim përfaqësuesit e Kuvendit Rinor të Prishtinës, ku u trajtuan çështje të ndryshme me interes për rininë e Prishtinës. Po ashtu, në këtë takimi u dha përkrahje se mbështetja e Drejtorisë së Arsimit do të jetë e vazhdueshme për Kuvendin Rinor, në implementimin e projekteve të ndryshme që janë në interes të rinisë (nxënësve) të kryeqendrës;
- Është realizuar analizë dhe vlerësim i përgjithshëm mbi gjendjen e institucioneve edukativo-arsimore, konkretisht fondin e orëve, dhe është realizuar sistemimi i mësimdhënësve që kanë mbetur pa orë ose më me pak orë mësimore, si rezultat i zhvillimeve reformuese në sistemin e arsimit parauniversitar dhe zvogëlimit të numrit të nxënësve në shkollat në zonat rurale;
- Hapja e konkursit për pranimin e stafit të ri arsimor, për vitin shkollor 2020-2021;



- Drejtoria e Arsimit, më 22 qershor 2020, ka hapur konkurs për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore, për vitin kalendarik 2020-2021;

### Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2020-2021

Grup-mosha	IP. Dielli	IP. Yllkat	IP. Fatosat	IP. Xixëllonjat	IP. Buzëqeshja	IP. Ardhmëria	IP. Lulevera	IP. Gëzimi Ynë	Gjithsej
1-2 vjeç	20	30	30	10	10	10	22	43	175
2-3 vjeç	0	6	6	10	12	6	12	12	64
3-4 vjeç	5	14	0		12	3	11	20	65
4-5 vjeç	4	0	2			5	0	7	18
5-6 vjeç	2	0	6			0	2	3	13
3-6 vjeç	0	0				0	0	8	8
<b>Gjithsej</b>	<b>31</b>	<b>50</b>	<b>44</b>	<b>20</b>	<b>34</b>	<b>24</b>	<b>47</b>	<b>93</b>	<b>343</b>

- Drejtoria e Arsimit, pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi trendët e regjistrimit të nxënësve në klasë X, më 17 qershor ka realizuar të gjitha planifikimet për regjistrimin e nxënësve në gjimnaze dhe shkolla profesionale, për vitin shkollor 2020-2021;
- Për të krijuar kushte dhe mundësi më të mira për mësimdhënie dhe mësim nxënie cilësore Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit qershor ka pajisur 12 institucione edukativo-arsimore me rekuizita sportive. Këto pajisje të standardeve të larta do t'u mundësojnë nxënësve arritjen e rezultateve të synuara në fushën e Edukatës Fizike, Sporti dhe Shëndeti;



- Riorganizimi i qendrave testuese për mbajtjen e Testit të maturës shtetërore 2020;
- Reduktimi i nxënësve nëpër qendra testuese, maksimum 200 kandidatë në një qendër;
- Planifikimi i klasave testuese me klasa me numër maksimum 12 nxënës;
- Përpilimi i listës së administruesve për Testin e maturës shtetërore 2020;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi në nivel komune ka operuar sipas planifikimeve të parapara për vlerësimin dhe adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet përkatëse. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues 5 fëmijë (4 vlerësime dhe 1 rivlerësim). Andaj, katër nga fëmijët janë referuar në institucione parashkollore dhe një nxënës në Qendrën Burimore “Përparimi”;
- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhune apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme konform legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe Rregullores komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Takime me prindër të shkollave të ndryshme;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit qershor 2020;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Vlerësimi i tenderit “Furnizimi me inventar i institucioneve arsimore”;
- Fillimi i implementimit “Furnizimi me perde i institucioneve arsimore”;
- Mbledhja e të dhënave për furnizim me libra për nxënësit e klasave 1-9;
- Fillimi i furnizimit me material higjienik i institucioneve arsimore;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;

- Zotimi i lëndëve.

### **3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Furnizimi me inventar i shkollave;
- Furnizimi me perde;
- Furnizimi me material higjenik.

#### **3.1.1. STATISTIKAT**

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuara, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

#### **3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, qershor – 2020**



## Buxheti i shpenzuar dhe alokuar qershor-2020

Kategoria eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim -Oblig.	Mbetje -S=
<b>Paga</b>	1,567,591.76	1,567,591.76	-	-
<b>Komunali</b>	132,582.34	55,483.08	4,842.32	72,256.94
<b>10-MSH</b>	250,815.99	115,180.99	16,800.00	118,835.00
<b>21-MSH</b>	325,689.00	-	49,168.36	276,520.64
<b>Subvencione</b>	33,450.00	7,850.00	5,250.00	20,350.00
<b>Donacione</b>	79,515.62	22,053.92	-	57,461.70
<b>Huaja-grant i BB</b>	158,637.00	-	-	158,637.00
<b>FB-21-Kapitale</b>	243,749.17	-	-	243,749.17
<b>FB-22-Kapitale</b>	2,801,912.12	78,343.62	18,600.00	2,704,968.50
<b>Totali:</b>	<b>5,593,943.00</b>	<b>1,846,503.37</b>	<b>94,660.68</b>	<b>3,652,778.95</b>

### 3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit qershor ka realizuar mbi 56 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë reduktua për shkak të pandemisë COVID-19.

### 4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit qershor të vitit 2020, janë realizuar takime me:

- ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- zyrtarët e MASHTI;
- drejtorin e Termokosit;
- përfaqësuesit e KRU "Prishtina";
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së;
- drejtorin e parkingjeve.

#### 4.1.1. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

### 5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit qershor 2020, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

#### **5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër**

- Gjatë muajit qershor 2020, janë pranuar gjithsej 83 lëndë, prej tyre të miratuara janë 19 lëndë, të refuzuara 16 lëndë, të pezulluara 21 lëndë, të anuluar 1 lëndë dhe në proces janë edhe 26 lëndë.

#### **6. Takime të tjera**

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara.

#### **7. SFIDAT**

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i Kurrikulës së re;
- Organizimi dhe mbajtja e mësimit në distancë.

#### **8. REKOMANDIME**

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.:

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;

- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës.

## 9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA. Rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Transferimi (migracioni) i brendshëm i personelit dhe i mësimdhënësve nga një shkollë në një shkollë tjetër dhe nga një vend pune në një tjetër, në bazë të nevojave dhe mundësive;
- Sistemimi i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA - shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe rritjet arsimore në vendet e zhvilluara;
- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla në viset rurale;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatim i monitorimit të kurrikulës;

- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimeve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësime dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Funksionalizimi i pajisjeve të TIK-së;
- Trajnimi i mësimeve;
- Aftësimi i mësimeve për përdorimin, mirëmbajtjen e laboratorëve dhe kabinetëve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Shërbimet shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike hartojnë plane pune të integruara sipas nevojave dhe kërkesave të IP-ve;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimit joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimit Profesional);
- Trajnimi i mësimeve për shmangie të ndëshkimit fizik ndaj nxënësve;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësime që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;

- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Indeksi i sigurisë;
- Përcjellja dhe realizimi i projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

## 10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.